



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 367/3 Prot.

Tiranë, më 29.01.2025

VENDIM

Nr. 4 Datë 29.01 2025

**“PËR
MIRATIMIN E PAGESËS SË KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME PËR
AKSIDENTE NË PUNË DHE SËMUNDJE PROFESIONALE PËR STUDENTËT
E FSHL CIKLI I DYTË MSH NË “ MËSUESI NË EDUKIM FIZIK DHE
SHËNDETËSOR” PËR KOHËN E KRYERJES SË PRAKTIKAVE
PROFESIONALE**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë" neni 38, në Statutin e UST-së, në Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe Udhëzimit nr.9, datë 20. 03. 2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, në VKM nr. 77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", i ndryshuar, kreu 1, pika 1, gërma f, kreu III, pika 12, në shkresën e FSHL me nr. 3835, datë 16.12.2024, "Për pagesën nga UST të kontributeve të detyrueshme të studentëve që do të zhvillojnë modulën Praktikë pedagogjike të programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor", në Vendimin e Rektoratit nr. 5 datë 13.01.2025, në Relacionin e Administratorit nr.164 datë 15.01.2024 , në Vendimin e Senatit Akademik nr.204/2 datë 20.01.2025,
Bordi i Administrimit,

V E N D O S I :

1. Të miratojë pagesën për studentët e Ciklit të Dytë Master i Shkencave "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Shëndetësor", për kohën e programuar të praktikës profesionale pedagogjike, për kontributin e detyrueshëm për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale gjatë kësaj periudhe.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetiti, Fakulteti i Shkencave të Levizjes, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

